

**Drejtuar:** Bashkimi i operatorëve ekonomik “RSM COMPANY” & “DESARET COMPANY” shpk

**Adresa:** Prishtinë, Çagllavicë, P.N.

### FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT (PARAPRAK)

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur” , “Projekti i sigurisë rrugore në disa vendkalime për këmbësore dhe numëruesve të biçikletave”.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF- 96830-02-28-2024.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Projekti i sigurisë rrugore në disa vendkalime për këmbësore dhe numëruesve të biçikletave”.

Fondi limit: **36,489,423.6** (tridhjetë e gjashtë milion e katërqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e njëzet e tre pikë gjashtë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 3 (tre) muaj kalendarike.

Publikimet e mëparshme: Buletini i Njoftimeve Nr. 13 datë 04.03.2024.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. Bashkimi i operatoreve ekonomik “RSM COMPANY” shpk & “DESARET COMPANY” shpk**

NUIS 810802422 & K01816001J

Vlera e ofertës = **26,405,463** (njëzet e gjashtë milion e katërqind e pesë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

**2. Operatori ekonomik “NIKA” shpk**

NUIS J76705047U

Vlera e ofertës = **26,638,383.45** (njëzet e gjashtë milion e gjashtëqind e tridhjetë e tetë mijë e treqind e tetëdhjetë e tre pikë dyzet e pesë) lekë pa TVSH.

*Nga pjesërmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm përkatësisht për arsyet e mëposhtme:*

## 1. Bashkimi i operatoreve ekonomik “NIKA” shpk

NUIS J76705047U

Operatori ekonomik “NIKA” Shpk nuk permbush Kriteret e Pergjithshme te Kualifikimit, pika 3, ku percaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt...”*. Nga verifikimi dokumentacionit te paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimit rezultoi se operatori ekonomik “NIKA” shpk per permbushjen e kriterit te mesiperm, ka deklaruar punonjesin me iniciale A. K i cili nga deklarimi perkates rezulton Ing. Topograf, cka bie ne kundërshtim me udhezimin Nr.2, date 13.05.2005, Kreu I, pika 2.1, paragrafi 2, ku citohet se: *“Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”*.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se bashkimin e operatoreve ekonomik **“RSM COMPANY” shpk & “DESARET COMPANY” shpk**, me adresë: *“Prishtinë, Çagllavicë, P.N”*, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **26,405,463** (njëzet e gjashtë milion e katërqind e pesë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në Nenin 109 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.